



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 26 maj 2014
Nr.ref.: RK634/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI02/14

Parashtrues

Hamdi Ademi

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-11-0069,
të 22 prillit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama- Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Hamdi Ademi, nga fshati Gllamnik, komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin ASC-11-0069 të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Ankesave) të 22 prillit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 3 maj 2013. Vendimi i lartcekur është shqyrtuar në Gjykatën Kushtetuese në rastin nr. KI73/13, Aktvendimi për papranueshmëri, të cilin Gjykata e ka shqyrtuar më 18 nëntor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit, i cili pretendohet t'ia pamundësojë parashtruesit realizimin e të drejtave në një pjesë të 20% të të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes shoqërore "Ramiz Sadiku" (në tekstin e mëtejme: NSH "Ramiz Sadiku") në Prishtinë.
4. Parashtruesi i kërkesës nuk përmend konkretisht nenet e Kushtetutës që janë cenuar.

Baza juridike

5. Baza juridike për parashtrimin e kërkesës është neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) si dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 9 janar 2014, parashtruesi ka parashtruar kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 30 janar 2014, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KIO2/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KIO2/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
8. Më 24 shkurt 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: DHPGJS), për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 2 prill 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 16 maj 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë e cila ishte regjistruar me numër KI73/13, duke kontestuar Vendimin ASC-11-0069, të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, të 22 prillit 2013.

11. Në kërkesën KI73/13, parashtruesi pretendon që aktgjykimi i kontestuar cenon të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, si të drejtën për jetë, të drejtën për punë, si dhe që është viktimë e diskriminimit.
12. Në kërkesën KI73/13, parashtruesi ka kërkuar nga Gjykata: *„ta fitojë të drejtën e 20% për punën që ka bërë në ndërmarrjen ‘Ramiz Sadiku’, dhe të paguhet për pushimin mjekësor prej datës së aksidentit në trafik e deri sa ai t’i mbushë 65 vjet“.*
13. Më 18 nëntor 2013, Gjykata e deklaroi kërkesën e parashtruesit të papranueshme (rasti nr. KI73/13, Aktvendimi për papranueshmëri).
14. Më 9 janar 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesë të re në Gjykatë (duke kontestuar vendimin e njëjtë si në rastin nr. KI73/13), të regjistruar me nr. KI02/14.
15. Në kërkesën nr. KI02/14, parashtruesi nuk ka dorëzuar fakte të reja apo ndonjë provë të re në lidhje me natyrën e rastit të tij, por shprehimisht kërkon që Gjykata: *„t’i mundësojë ballafaqimin me Sekretarin e NSH ‘Ramiz Sadiku’, të cilin e konsideron personin e vetëm përgjegjës për humbjen e të drejtës në 20% të privatizimit“.*

Pretendimet e parashtruesit

16. Parashtruesi në kërkesë pretendon që ka humbur të drejtën në 20% të privatizimit për shkak të gabimit të personit përgjegjës në ndërmarrjen NSH “Ramiz Sadiku”.
17. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën:

„Dua të ballafaqohem me ish-sekretarin e Ndërmarrjes ‘Ramiz Sadiku’, i cili e ka humbur dokumentacionin tim në lidhje me historinë e punës në ndërmarrjen ‘Ramiz Sadiku‘“.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata, së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kërkesat e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë si dhe të specifikuara më tutje me Ligj dhe me Rregullore të punës.
19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.1 të Kushtetutës [Efekti Juridik i Vendimeve], i cili përcakton që:

„1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës“.

20. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 63 (1) të Rregullores së punës, i cili përcakton që:

„(1) Vendimet e Gjykatës janë të obligueshme për gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës“.

21. Për më tepër, rregulli 36 (3) e) i Rregullores së punës përcakton që:

„(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:

(...)

e) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri“.

22. Gjykata konsideron që faktet dhe pretendimet që parashtruesi i ka dhënë në kërkesën e re nuk paraqesin bazë e as arsye të mjaftueshme e relevante për vendim të ri.

23. Në të vërtetë, Gjykata përkujton që tashmë është marrë me rastin e përmendur nr. KI73/13, Aktvendimi për papranueshmëri, në të cilin, më 18 nëntor 2013, e deklaroi aktvendimin për papranueshmëri të kërkesës. Gjykata në aktvendim ka theksuar që parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij në lidhje me shkeljen e dispozitave kushtetuese, sepse faktet që ai i ka parashtruar në asnjë mënyrë nuk vërtetojnë që Trupi gjykues dhe Kolegji i Ankesave të Dhomës së Posaçme i kanë cenuar të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

24. Gjykata gjen që tashmë ka marrë vendim për çështjen në fjalë, ndërsa kërkesa nuk përmban baza të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri.

25. Andaj, Gjykata e deklaron kërkesën të papranueshme në pajtim me rregullin 36 (3) e) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (3) e të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 2 prill 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani